



VENDIM

Nr.125, datë 29.07.2016

**MBI
MIRATIMIN E RREGULLORES PËR PROCEDURAT E VENDOSJES
DHE REDUKTIMIT TË GJOBAVE**

Në mbështetje të neneve 16; 106/2; 107 pika 4 dhe 110 të Ligjit Nr. 43/2015 ‘Për Sektorin e Energjisë Elektrike’, nenit 26 të ‘Rregullores së Organizimit, Funksionimit dhe Procedurave të ERE’, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 29.07.2016, pasi shqyrtoi Draft-Rregulloren për procedurat e vendosjes dhe reduktimit të gjobave, të përgatitur nga Drejtoria Juridike si dhe relacionin përkatës:

Konstatohet se:

- Në bazë të nenit 107, pika 4, ERE ka detyrimin të hartojë dhe miratojë një rregullore të posaçme lidhur me kushtet dhe procedurat e vendosjes dhe reduktimit të gjobave.
- Me vendimin nr. 152, datë 11.12.2015, Bordi i ERE ka filluar procedurat për miratimin e “Draft - Rregullores për vendosjen e gjobave dhe kushtet e lehtësimit prej tyre”.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE,

Vendosi:

1. Të miratojë Rregulloren për procedurat e vendosjes dhe reduktimit të gjobave.
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për Vendimin e Bordit të ERE.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

RREGULLORE
PËR PROCEDURAT E VENDOSJES DHE REDUKTIMIT TË GJOBAVE

Pjesa e Parë

Dispozita të Përgjithshme

Neni 1

Autoriteti

Kjo rregullore hartohet në zbatim të nenit 106/2 dhe 107 të Ligjit nr.43/2015 "Per Sektorin e Energjise Elektrike", Ligjit 45/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë" dhe në përputhje me "Rregullore për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s".

Neni 2

Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregullore është të sigurojë një trajtim të barabartë e transparent për të gjithë të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike për të cilët ERE nis procedurën për vendosjen e gjobave për shkeljet e konstatuara sipas parashikimeve të Ligjit nr.43/2015 "Per Sektorin e Energjise Elektrike"

ERE aplikon procedura të njëjta për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike në rastet e vendosjes së gjobave.

Neni 3

Objekti

Kjo rregullore përcakton procedurat e aplikimit të gjobave, metodologjinë e konstatimit e përcaktimit të tyre si dhe masat e lehtësimit që aplikohen për gjobat e vendosura, për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike, në rastet e shkeljeve të ndërshkueshme me gjobë nga ERE.

Neni 4

Përkufizime

Fjalët dhe frazat e mëposhtme të përdorura në këtë Rregullore kur përdoren, do të kenë kuptimet e mëposhtme:

1. "Ligj" do të thotë Ligji nr.43/2015 "Per Sektorin e Energjise Elektrike".

2. “Bordi i ERE” do të thotë organi vendimmarrës i ERE-s që përbëhet nga pesë anëtarë të emëruar sipas procedurave të parashikuara në ligj.
3. “ERE” do të thotë Enti Rregullator i Energjisë.
4. “Licensë” do të thotë një e drejte e dhënë nga ERE-ja, një personi për ushtrimin e nje veprimtarie ne sektorin e energjisë elektrike ose ate te gazit natyror ne perputhje me dispozitat qe kerkohen nga Ligji nr. 43/2015 “Per Sektorin e Energjise Elektrike” dhe Ligjit nr. 102/2015 “Per Gazin Natyror” si dhe procedurave te licensimit te ERE-s
5. “I licensuar” do të thotë një person i pajisur me një licensë të dhënë nga ERE për të operuar në sektorin e energjisë elektrike ose dhe te Gazit Natyror.
6. “Procedurë” do të thotë një tërësi e veprimeve të ERE apo të të licencuarve që kryen në zbatim të legjislacionit në fuqi.
7. “Administratori” do të thotë sipas rastit Kryetari i Bordit të ERE ose Bordi i ERE
8. “Subjekt i interesuar” do të thotë çdo i licensuar apo çdo person tjetër qe merr shërbim apo kryen aktivitet ne sektorin e energjise elektrike.
9. “Të ardhurat vjetore” do të thotë totali i të ardhurave të gjeneruara nga shitja e të mirave të sigurara nga aktiviteti në sektorin e energjisë elektrike apo shërbimeve të kryera gjatë një viti financiar nga një subjekt tregtar.
10. “Xhiro mesatare ditore” do të thotë të ardhurat mesatare të sigurura në ditë nga shitjet përgjatë nje viti financiar.
11. “Vlera fillestare e gjobës” do të quhet vlera e përcaktuar nga Bordi i ERE për efekt të llogaritjes së vlerës përfundimtare të gjobës e cila llogaritet sipas Aneksit nr. 1 bashkengjitur kësaj Rregullore.

PJESA E DYTË
DISPOZITA TË POSAÇME

Neni 5

Gjobat

1. Cdo i licensuar mund të jetë subjekt i ndëshkimit nga ERE për një ose më shume nga shkeljet e kryera prej tij si më poshtë:
 - a. Moszbatim i vendimeve të ERE-s;

- b. Refuzimi i paraqitjes së të dhënave dhe raporteve periodike apo dërgimi me vonese i tyre, ose dërgimi i të dhënave jo të plota dhe të pasakta nga i licensuari. Dërgimi i qëllimshëm i të dhënave të rreme, përbën vepër penale, e ndëshkohet konform parashikimeve të Kodit Penal;
 - c. Moszbatimi i detyrimeve që lidhen me llogaritjen e kostove dhe tarifave si dhe zbatimin e tyre;
 - d. Mos zbatimi i detyrimeve të shërbimit publik, të parashikuar në nenin 47 të Ligjit nr.43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”;
 - e. Moszbatimi i detyrimeve për ndarjen e veprimtarive të licencuara;
 - f. Moszbatimi i detyrimit për mbajtjen e llogarive të ndara sipas neneve 35, 54 dhe 72 të Ligjit nr.43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”;
 - g. Moszbatimi i detyrimeve që lidhen me aksesin e paleve të treta në rrjet siç përcaktohet nga dispozitat e Ligjit nr.43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” dhe aktet e tjera nenligjore;
 - h. Moszbatimi i detyrimeve të përcaktuara në kontratat e rregulluara;
 - i. Mospublikimi i informacionit për tarifën dhe kushtet e përgjithshme të aksesit dhe përdorimit të shërbimeve të rrjetit;
 - j. Mosparaqitja e programeve të investimeve dhe / ose moskryerja e investimeve të planifikuara, sipas kërkesave të neneve 20, shkronja “f”, 60 dhe 75, të Ligjit nr.43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, dhe rregullores përkatëse të ERE-s;
 - k. Shkelja e një prej kushteve të kërkesave të cilësisë së furnizimit, të miratuara nga ERE;
 - l. Moszbatimi i vendimeve të ERE-s për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të licensuarve;
 - m. moskryerja e pagesës rregullatore nga ana e të licensuarit brenda afatit të përcaktuar
 - n. refuzimi i pjesëmarrësve të tregut për të nënshkruar kontrata të rregulluara brenda 15 ditëve kalendarike;
 - o. Shkeljet e kushteve të përcaktuara në licensë, apo shkeljet e rregullave dhe rregulloreve të ERE-s, që nuk janë përcaktuar në shkronjat e mësipërme.
2. ERE mund të vendosë gjobë progresive për çdo ditë vonesë në korrigjimin e shkeljes, duke filluar ky afat nga dita e afatit të përcaktuar nga ERE për korrigjimin e saj apo nga legjislacioni në fuqi.
- a. kur i licensuari nuk përmbush vendimin e ERE-s për korrigjimin e një shkeljeje brenda afateve të përcaktuara prej saj, i licensuari dënohet me gjobë në masën 0,1 për qind të xhiros mesatare ditore të vitit financiar paraardhës, për çdo ditë vonesë nga dita e afatit të përcaktuar në vendimin përkatës të ERE-s;
 - b. kur i licensuari nuk përmbush detyrimin e pageses rregullatore ndaj ERE-s, dënohet me gjobë në masën 0,2 për qind të xhiros mesatare ditore të vitit financiar paraardhës, për çdo ditë vonesë nga dita e përcaktuar për pagesën.

3. Masat e gjobës do të përcaktohen nga ERE në përputhje me Aneksin 1, të kësaj Rregulloreje, brenda kufijve si më poshtë:
 - a. Jo më shumë se 3% e të ardhurave vjetore të vitit financiar paraardhës të të licensuarit.
 - b. Jo më pak se 0,1% e të ardhurave vjetore të vitit financiar paraardhës të të licensuarit.
4. Gjoha progresive për çdo ditë vonese, nuk mund të kalojë vetë vlerën e gjobës fillestare ose masën e 3 % të të ardhurave të vitit paraardhës
5. Vlera përfundimtare e gjobës do të përcaktohet si zbritje e vlerës fillestare të gjobës me vlerën e kushteve lehtësuese nëse kjo e fundit mund të aplikohet.

Neni 6

Fillimi i hetimit

1. ERE mund të fillojë një hetim për vendosje gjobe, në rastet kur:
 - a. Ka marrë kryesisht dijëni për një shkelje;
 - b. Vihet në dijeni nga një i licensuar tjetër apo nga një subjekt i interesuar për një shkelje.
 - c. Ka dyshimin e arsyeshëm se kushtet e licensës janë shkelur
2. Në çdo rast fillimi i hetimit vendoset me urdhër të Administratorit apo vendim të Bordit të ERE.

Neni 7

Shqyrtimi fillestar

1. ERE nuk mund të vendosë për fillimin e një procedure për vendosje gjobë, nëse shkelja e pretenduar apo konstatuar pas hetimit rezulton se ka më shumë se 5 vjet që ka ndodhur.
2. Në çdo rast që stafi teknik i cili ka kryer hetimin, konstaton një nga shkeljet e parashikuara në nenin 5, do të përgatisë një informacion/relacion të detajuar mbi shkeljen/et e konstatuara dhe propozimin për fillimin e procedurës për vendosje gjobe ndaj të licensuarit.

3. Vendimi i Bordit të ERE-s për të filluar procedurën e vendosjes së gjobës një të licensuari, do t'i njoftohet të licensuarit nga ERE, brenda 5 ditëve pune nga marrja e vendimit të Bordit të ERE.
4. Njoftimi për vendosjen e gjobës do të përmbajë:
 - Shkeljen e konstatuar
 - Masën e Gjobës së propozuar
 - Identitetin e të licensuarit
 - Dokumentacionin provues ku mbështetet vendosja e gjobës
 - Të drejtën e të licensuarit për të kthyer përgjigje brenda 10 ditëve kalendarike, nga marrja ne dijeni, si dhe paraqitjen e argumentave dhe çdo dokumentacioni shkresor mbështetës në funksion të përgjigjes së tyre apo për qëllime të aplikimit të rrethanave lehtësuese. I licensuari ka të drejtë që brenda këtij afati, të kërkojë zhvillimin e një seance dëgjimore për të bërë sqarimet e duhura.
5. Në cdo fazë të një procedimi për vendosje gjobe, ERE mund të kryejë seanca dëgjimore me të licensuarin dhe subjektin që ka kërkuar kryejën e hetimit, apo ERE mund të kërkojë dokumenta të tjerë të nevojshëm për qëllime të procedurës së nisur.

Neni 8

Përcaktimi i vlerës fillestare të gjobës

1. ERE do të përcaktojë vlerën fillestare të gjobës brenda kufirit maksimal dhe minimal të vendosur në ligj. Rëndësia e shkeljes do përcaktohet sipas kriterëve të mëposhtme:
 - a. rrethanat e kryerjes së kundërvajtjes;
 - b. nëse kundërvajtësi rezulton i dënuar administrativisht më parë;
 - c. rëndësinë e kundërvajtjes;
 - d. pasojat që kanë ardhur nga veprimi apo mosveprimi.
 - e. nëse kundërvajtësi është dënuar më parë për të njëjtën kundërvajtje

Neni 9

Rrethanat e kryerjes se kundërvajtjes

1. Për efekt të llogaritjes së vlerës fillestare të gjobës rrethanat e kryerjes së shkeljes do të konsiderohen të lehta, mesatare apo të rënda.
2. Për përcaktimin e niveleve të rrethanave do merren për bazë kriteret e mëposhtëme:
 - a. Pozicioni hierarkik në kompani i personit që ka kryer shkeljen;

- b. Mungesa e modeleve organizative dhe të rregullave të menaxhimit korrekt me qëllim parandalimin e kryerjes së shkeljes;
- c. Përpjekjet për të fshehur shkeljen

Neni 10

Subjekti me precedentë dënimi administrativ

Nëse i licensuari është dënuar më parë për shkelje të legjislacionit të Sektorit të Energjisë, është dënuar më parë për të njëjtën kundërvajtje administrative, gjoha përfundimtare e parashikuar për llojin e kundërvajtjes, do të rritet në masën 10 % të vlerës së gjobës minimale te kriterit perkates të parashikuar në aneksin 1.

Neni 11

Rëndësia e shkeljes së kryer

1. Për efekt të llogaritjes së rëndësisë së shkeljes së kryer, ato do të konsiderohen të rëndësisë së ulët, mesatare apo të lartë.
2. Për përcaktimin e nivelit të rëndësisë së shkeljes së kryer do të merret për bazë:
 - a. Përfitimi financiar i realizuar nga i licensuari i cili do të llogaritet mbi bazën e raportit të të ardhurave të përfituara me të ardhurat vjetore të vitit paraardhës të të licensuarit
 - b. Dëmi i shkaktuar në palë të treta.

Neni 12

Pasojat që kanë ardhur nga veprimi apo mosveprimi

1. Për efekt të llogaritjes së vlerës fillestare të gjobës, pasojat që kanë ardhur nga veprimi apo mosveprimi i të licensuarit do konsiderohen të nivelit të ulët, mesatar apo të lartë.
2. Për përcaktimin e niveleve të pasojave do merren për bazë kriteret e mëposhëtmë:
 - a. Dëmi i shkaktuar apo rritja e kostove të shkaktuara konsumatorëve apo pjesëmarrësve në treg;
 - b. Numri i klientëve të përfshirë;
 - c. Rritja e dominancës në treg të të licensuarit;
 - d. Pengimi i punës së Rregullatorit në kryerjen e funksioneve të veta ligjore për monitomin dhe kontrollimin e të licensuarit.

Neni 13

Lehtësimi Nga Gjoha

1. ERE do të konsiderojë se i licensuari plotëson kushtet për lehtësimin në vlerën e gjobës, kur gjatë hetimit rezulton se ekzistojnë një ose të gjitha rrethanat si më poshtë:
 - a. në masën 50 për qind, në rastet kur shkelja, për të cilën parashikohet gjoha, është njoftuar nga vetë i licensuari;
 - b. në masën 1/3, në rastet kur i licensuari bashkëpunon në mënyrë aktive në procesin e hetimit administrativ të ERE-s për konstatimin e shkeljes në fjalë;
 - c. në masën 40 për qind, në rastet kur i licensuari provon se ka ndërmarrë veprime konkrete për përmirësimin apo zhdukjen e pasojave që ka shkaktuar shkelja, përpara ose gjatë konstatimit të shkeljes nga ERE.
 - d. do të konsiderohen veprime që çojnë në përmirësimin e tregut, veprimet të cilat pavaresisht shkeljes kanë ndikuar në përmirësimin e standarteve të shërbimit, konkurrencës, eficientësisë në treg etj.

Neni 14

Propozimi Përfundimtar

1. Pas marrjes së përgjigjes me shkrim nga i licensuari brenda afatit të përcaktuar më sipër, personat e ngarkuar që ndjekin këtë procedurë në ERE, do të shqyrtojnë këtë përgjigje brenda afatit të vendosur nga Bordi i ERE-s dhe do të përgatisin një relacion për Bordin mbi argumentat e paraqitur në përgjigjen e të licensuarit, rrethanat lehtësuese dhe gjithë dokumentacionin mbështetës nëse ka, dhe do të propozojnë Bordit të ERE përmbylljen e procedurës së nisur për vendosjen e gjobës, vlerën fillestare të gjobës dhe nëse ekzistojnë kushtet për uljen e vlerës së gjobës së propozuar apo mos gjobitjen e të licensuarit për mos konstatim të shkeljes.
2. Bordi i ERE mund të vendosë të mos gjobisë të licensuarin sipas propozimit të stafit teknik nëse konstaton se faktet e paraqitura nuk provojnë shkeljen.

Neni 15

Vendimi I Bordit

1. Me marrjen e informacionit të detajuar me të dhënat sipas dispozitave të mësipërme të kësaj rregulloreje dhe pasi është njohur me përgjigjen e të licencuarit, Bordi i ERE do të vendosë për ndëshkimin ose jo të të licencuarit dhe vlerën përkatëse të gjobës.
2. Në përfundim të një procedure për vendosjen e gjobës një subjekti të licensuar, ERE do të njoftojë të licencuarin mbi përfundimin e procedurës së nisur ndaj tij si dhe do ti dërgojë një kopje të Vendimit të Bordit, brenda 7 diteve kalendarike nga marrja e vendimit.
3. Gjoha e vendosur nga Bordi i ERE përben titull ekzekutiv dhe do të ekzekutohet në përputhje me Kodin e Procedurës Civile.

Neni 16

Apelimi i vendimit

Kundër Vendimit të Bordit të Komisionerëve për vendosje të gjobes, i licencuari mund të bëjë ankim në përputhje me Ligjin nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”

PJESA E TRETË

Dispozita te Fundit

Neni 17

Amendamente të rregullores

Këto rregulla janë objekt rishikimi dhe ndryshimi me vendim të Bordit të ERE-s në përputhje me “Rregullore për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”.

Neni 18

Hyrja në Fuqi

Kjo Rregullore dhe pjesët përbërëse të saj, hyjnë në fuqi pas publikimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

Aneksi 1

Tabela per llogaritjen e vleres perfundimtare te gjobes

Faza I; Fiksimi i vleres fillestare te gjobes, ne varesi te rendesise se shkeljes			
Kriteret e rendesise se shkeljes			
1. Kohezgjatja e shkeljes dhe Shtirirja territoriale e saj	25 %	E shkurter	2 %
		E mesme	6%
		E gjate	12 %
		Lokale	2 %
		Rajonale	4 %
		Kombetare	13 %
2. Ndikimi I shkeljes ne funksionimin e tregut te energjise	25 %	I ulet	2 %
		I mesem	6 %
		I larte	13 %
3. Perfitimi ekomomik i realizuar nga i licensuari si pasoje e shkeljes	25 %	I ulet	4 %
		Mesatar	8 %
		I larte	12 %
4. Lloji i fajesise se te licensuarit	25 %	Dashje	17 %
		Pakujdesia	8 %
Faza II: Llogaritja e gjobes perfundimtare do behet sipas formules:			
Gj= VFGj-KL			
Ku GJ = Gjoba			

VFGJ = Vlera fillestare KL = Kushtet Lehtesuese		
Kushtet Lehtesuese	1. Shkelja per te cilen parashikohet gjobe deklarohet nga vetë i licensuari	50%
	2. I licensuari bashkepunon ne menyre efikase ne procesin e investigimit te rregullatorit per shkeljen ne fjale	33%
	3. I licensuari demonstroi se ka bere veprime qe cojne ne permiresimin e tregut te rregulluar	40%